



EUROPEAN QUALIFIERS



VS



SHQIPËRI VS SERBI

ASGJË
MË SHUMË
SËSA NJË NDESHJE
FUTBOLLI

7 QERSHOR 2025

20:45

AIR ALBANIA
STADIUM



No one was born a hero.

It's an everyday journey.

There are no shortcuts.

No days off.

No perfect scenarios.

*Things won't always go
the way you expect.*

*But overcoming challenges
is part of the game too.*

Your time is now.

When passion runs through you,

**BECOME
YOUR OWN
HERO.**



SCAN THE QR CODE
AND DISCOVER MORE
ABOUT MACRON



TË DASHUR TIFOZË, MIQ TË FUTBOLLIT TË APASIONUAR PAS KOMBËTARES SONË,

Më 7 qershor, në stadiumin tonë të bukur "Air Albania", Kombëtarja shqiptare do të zbresë në fushë për të zhvilluar një nga sfidat më të rëndësishme të këtij edicioni kualifikues për Kupën e Botës 2026. Përballë do të jetë një kundërshtar me emër, Serbia, dhe padyshim që vëmendja për këtë ndeshje është e madhe, jo vetëm për aspektin sportiv, por edhe për historinë mes dy vendeve tona.

Por sot, më shumë se kurrë, dua të theksoj qartë: kjo është një ndeshje futbollit. Dhe si e tillë duhet trajtuar nga të gjithë – nga futbollistët, tifozët, media dhe publiku i gjerë. Futbollit nuk është mjet ndarjeje, por bashkimi. Është një garë që zhvillohet mbi bazën e rregullave, respektit dhe meritës. Ne duhet të fokusohemi vetëm tek loja, tek skuadra jonë dhe mbi të gjitha tek objektivi madhor që kemi përpara: kualifikimi për herë të parë në historinë tonë në një Kampionat Botëror.

Ky është një qëllim i madh, por jo i paarritshëm. Shqipëria sot ka një ekip të ndërtuar me kujdes, me një grup lojtarësh të talentuar, profesionistë dhe të motivuar për të shkruar historinë. Kemi një staf teknik që po bën punë të palodhur për të rritur më tej performancën dhe kohezionin e skuadrës. Kemi një tifozeri që nuk resht së mbështeturi ekipin dhe që është kthyer në simbol të pasionit e dashurisë për fanellën kuqezi.

Kjo ndeshje ndaj Serbisë është një mundësi për të treguar vlerat tona si vend: mikpritjen, qytetarinë, maturinë dhe mbi të gjitha sportivitetin. Pavarësisht çdo konteksti

historik apo tensioni të së shkuarës, në fushat e futbollit nuk ka vend për urrejtje. Janë vende ku luhet me zemër për fitoren, por edhe me respekt për kundërshtarin.

Në aspektin sportiv, për ne është një ndeshje që vlen shumë. Jemi në një grup të vështirë dhe çdo pikë ka një rëndësi jetike në rrugëtimin drejt "Botërorit 2026". Duhet të japim maksimumin në fushë për të arritur një rezultat pozitiv dhe për të qëndruar fort në garë për një vend në fazën finale të këtij kompeticioni. Të gjithë bashkë – lojtarë, staf dhe tifozë – duhet të jemi një trup i vetëm, me një qëllim të vetëm: të mbështesim Shqipërinë dhe ta çojmë atë sa më larg.

Dua të falënderoj nga zemra të gjithë ata që punojnë çdo ditë në prapaskenë për këtë ndeshje – institucionet shtetërore, partnerët tanë vendorë dhe ndërkombëtarë, stafin e Federatës dhe të stadiumit – për të garantuar një organizim dinjitoz, me standarde të larta evropiane.

E njëjta thirrje vlen edhe për tifozët tanë të zjarrtë: të mbështesin ekipin me pasion, por gjithnjë me qytetari e përgjegjësi. Të jemi shembull për mënyrën se si duam futbollin dhe për mënyrën se si e trajtojmë një ndeshje të këtij niveli. Fitorja më e madhe nuk është vetëm ajo në rezultat, por ajo në imazh, dinjitet dhe sjellje.

Uroj që të gjithë së bashku të përjetojmë një mbrëmje të paharrueshme në "Air Albania", me emocione të forta, me ndjenja të larta dhe – pse jo – me një fitore të madhe për Kombëtaren tonë.

Me respekt dhe krenari,
ARMAND DUKA
President i Federatës Shqiptare të Futbollit



Rrugëtimi i deritanishëm i Shqipërisë

NË KUALIFIKUESËT E BOTËRORIT

»» 2026

Rrugëtimi i Shqipërisë në kualifikueset e Botërorit 2026 ka nisur në mënyrë të ngjashme me atë të Europeanit 2024, ku kuqezinjtë siguruan për herë të dytë pjesëmarrjen në një turne madhor si Euro 2024.



Ashtu si në atë fushatë, ku kuqezinjtë u mundën në ndeshjen e parë ndaj Polonisë, edhe në këto kualifikuese Shqipëria e nisi me një disfatë në "Wembley" ndaj Anglisë. Megjithatë, skuadra reagoi menjëherë dhe siguroi fitoren 3-0 ndaj Andorrës në "Arenën Kombëtare", duke marrë tri pikët e para në grup. Triumf që riktheu besimin dhe tregoi se skuadra është e përqendruar në objektivat afatgjatë.

Muaji qershor sjell dy ndeshje vendimtare. Më 7 qershor, Shqipëria pret Serbinë në Tiranë, në një përballje me shumë interes, si për ecurinë në grup ashtu edhe për emocionet që kjo ndeshje ngjall. Tri ditë më vonë, më 10 qershor, kuqezinjtë do të luajnë në transfertë ndaj Letonisë, në stadiumin "Skonto", në orën 20:45.

Kombëtarja vjen në këto ndeshje me përqendrim maksimal, ndërsa mbështetja e tifozëve mbetet një forcë shtesë për të përballuar çdo sfidë.



KALENDARI I NDESHJEVE TË SHQIPËRISË

ANGLI	2-0	SHQIPËRI
21 MARS 2025 / WEMBLEY / 20:45		
SHQIPËRI	3-0	ANDORRA
24 MARS 2025 / 20:45		
SHQIPËRI	VS	SERBI
7 QERSHOR 2025 / 20:45		
LETONI	VS	SHQIPËRI
10 QERSHOR 2025 / 20:45		
SHQIPËRI	VS	LETONI
9 SHTATOR 2025 / 20:45		
SERBI	VS	SHQIPËRI
11 TETOR 2025 / 20:45		
ANDORRA	VS	SHQIPËRI
13 NENTOR 2025 / 20:45		
SHQIPËRI	VS	ANGLI
16 NENTOR 2025 / 20:45		



sigal.com.al

Mbrojtje e plotë për makinën tuaj

Një makinë e siguruar është një hap i sigurt për të udhëtuar pa bregua. Me sigurimin KASKO, ju përfitoni:

- ✓ Mbrojtje nga dëmet aksidentale
- ✓ Dëmtimet nga zjarri, rrufeja, shpërthimi
- ✓ Mbrojtje nga ngjarje natyrore
- ✓ Vjedhja

Sigurimi
KASKO
i makinës
vetëm tek
SIGAL





SHQIPËRI - SERBI

ASGJË MË SHUMË SESA NJË NDESHJE FUTBOLLI

7 qershori i vitit 2025 është ndoshta një nga datat më të përfolura të këtij viti në futbollin shqiptar. Një datë që do të komentohet dhe do të mbahet mend gjatë nga të gjithë futbolldashësit, ashtu sikurse edhe 14 tetori i vitit 2014 dhe 8 tetori i vitit 2015. Dy datat e fundit dhe në fakt të vetmet zyrtare kur Shqipëria është përballur me Serbinë në fushën e gjelbërt. Topi do të rrokulliset sërisht sonte duke nisur nga ora 20:45 në stadiumin "Air Albania Stadium" në Tiranë. E megjithëse në letër kjo është thjesht ndeshja e radhës e

vlefshme për kualifikueset e Botërorit 2026, për shumëkënd kjo përballje përfaqëson më tepër. Që nga hedhja e shortit më 12 dhjetor e deri më sot, vëmendja në rrjetet sociale, në media dhe bar-kafenetë ku kuvendohet shqip, është te ndeshja e sotme ndaj Serbisë. Duke lënë në fakt në hije edhe kundërshtarët e tjerë të grupit si Anglia, Andorra e Letonia.

Por në vitin 2025, në një epokë ku pretendohet se e ardhmja i përket paqes, zhvillimit e fëmijëve dhe jo luftës e të kaluarës, vijohet të flitet ende për luftë, rrëmuja e sharje. Askush nuk mohon e harron të kaluarën. Në

fakt, do të ishte gabim i madh nëse do ta bënim. Por futbollit nuk e di se ç'është e kaluarës. Nuk e di as se çfarë ngjyrimesh politike ka përtej atyre metrave katrorë të stadiumit. As se çfarë ndjejnë tifozët nga brenda. Një top, 22 lojtarë, një fushë 105x68 metra, dy trajnerë, një gjyqtar dhe mijëra tifozë që duan të shohin lojën, jo të shfryjnë të kaluarën. Kjo është gjithçka që i duhet një ndeshjeje futbollit. Asgjë më shumë.

Të gjithë ata që kanë siguruar një biletë për të ndjekur ndeshjen Shqipëri - Serbi sonte në stadiumin "Air Albania Stadium" duhet të kujtojnë se sporti nuk është politikë, as hakmarrje dhe as shfaqje force.

Ndeshja Shqipëri - Serbi nuk është asgjë më shumë sesa një ndeshje futbollit. Emocionet sportive duhet t'i mbajmë brenda sportit. Shqipëria e futbollit sonte nuk ka nevojë për të kujtuar të kaluarën. Shqipëria e futbollit ka nevojë sonte për ta ndihmuar sportivisht, për t'i dhënë një mbështetje që e meriton dhe për ta përjetuar këtë përballje thjesht dhe vetëm si një ndeshje futbollit.

E vetmja fitore që i duhet Shqipërisë sonte nuk janë as koret e shëmtuara, as fyerjet, as rrëmuja e shkatërrimet. Shqipërisë i duhet rezultati, i duhen tre pikët. Shqipërisë i duhet të ecë përpara në ëndrrën për finale të "Botërorit 2026".



FEDERATA
SHQIPTARE E
FUTBOLLIT

ANËTARËSOHU

TANI TEK KLUBI
TIFOZËT E KOMBËTARES



DHE PERFITO NGA AVANTAZHET E SHUMTA EKSKLUZIVE

Fanzone.fshf.org



Nis me një pikë.

Uji i Ftohtë Tepelene sh.p.k.

© 2025



STAFI TEKNIK I KOMBËTARES



Eksperienca e vërtetë
5G me Vodafone,
Rrjetin Nr. 1 në Shqipëri!



Together we can



SHQIPËRIA



Coach



ALEN SHERRI



ARDIAN ISMAJLI



MARIO MITAJ



YLBER RAMADANI



KRISTJAN ASLLANI



MIRLIND DAKU



THOMAS STRAKOSHA



ARLIND AJETI



BERAT GJIMSHITI



MEDON BERISHA



ERNEST MUÇI



ARMANDO BROJA



ELHAN KASTRATI



MARASH KUMBULLA



NASER ALIJI



QAZIM LAÇI



JULJAN SHEHU



JASIR ASANI



MARIO DAJSINANI



IVAN BALLIU



ADRIAN BAJRAMI



ADRION PAJAZITI



NEDIM BAJRAMI



MYRTO UZUNI



REY MANAJ



ELSEID HYSAJ



ARBËR HOXHA



WELCOME **ALL**

*Sharing the love of the game
across generations*

#FOOTBALL
UEFA



 **CREDINS
BANK**

**Sponsor i
Kombëtares
Shqiptare**

Skano për
më shumë




SERBIA



Coach

STOJKOVIC

СРБИЈА



**DORĐE
PETROVIĆ**



**ALEKSA
TERZIC**



**NEMANJA
MAKSIMOVIC**



**ANDRIJA
MAKSIMOVIC**



**NIKOLA
STULIC**



**SRDJAN
BABIC**



**ALEKSANDAR
KATAI**



**ANDRIJA
ZIVKOVIC**



**ALEKSANDAR
MITROVIC**



**LAZAR
KALICANIN**



**JAN
CARLO SIMIC**




**NIKOLA
MILENKOVIC**



**UROŠ
RACIC**



**SASA
LUKIC**



**DUSAN
VLAHOVIC**



**DRAGAN
ROSIC**



**KOSTA
NEDELJKOVIC**



**NEMANJA
GUDELJ**



**STRAHINJA
PAVLOVIC**



**STEFAN
MITROVIC JR**



**NEMANJA
STOJIC**



**LAZAR
SAMARDZIC**



**STRAHINJA
ERAKOVIC**



**LUKA
JOVIC**



ZENITH
TRAVEL & TOURS

JETO ME EMOCION

GUIDA ME AUTOBUS
GUIDA ME AVION
DESTINACIONE EKZOTIKE
PAKETA INDIVIDUALE

**PUSHIME VERORE
AVENTURA
EMOCIONE TË
PAHARRUESHME**



Zenith Travel nisi aktivitetin në vitin 1992 nga familja Sula, me qëllimin për të ofruar udhëtime të rehatshme dhe të përballueshme. Me kalimin e viteve, kompania u zhvillua në një agjenci të mirëfilltë turistike me qendër në Tiranë, duke zgjeruar shërbimet në udhëtime me avion dhe paketa të personalizuar. Që nga viti 2021, Zenith operon edhe si "Tour Online Operator", duke ofruar të gjithë informacionin dhe rezervimet online.

+355 694000016 info@zenithtravel.al



Nga **2014** -a
në **2025** -ën



**ELSEID
HYSAJ**

**I FUNDIT
i mohikanëve**

KUQEZI NDAJ SERBISË



Është vetëm 31 vjeç dhe i mungojnë vetëm katër ndeshje me Kombëtaren për të thyer rekordin e Lorik Canës. Me plot 89 ndeshje të luajtura me fanellën kuqezi, emocionet që përjeton kur mbron ngjyrat e Shqipërisë nuk krahasohen me ato të një klubi. Me Kombëtaren, i thërret gjaku.

Eldar Hysaj është i vetmi lojtar i mbetur nga brezi i kuqezinjve që përballuan përfaqësuesen serbe në ndeshjet e viteve 2014-2015. Në një paralelizëm kinematografik, mund ta quajmë "i fundit i mohikanëve" kuqezi.

Mbrojtësi, që ka mbajtur për disa ndeshje edhe shiritin e kapitenit, rrëfen në një intervistë për FSHF – e përgatitur posaçërisht për broshurën e ndeshjes Shqipëri-Serbi, emocionet e përballjes së fundit me Serbinë në Elbasan dhe përgatitjet që ka zhvilluar skuadra në këtë periudhë.

- Elseid, si e kujton ndeshjen e fundit në Elbasan kundër Serbisë? Jeni i vetmi lojtar i ftuar në këtë grumbullim që ka luajtur ndaj Serbisë në Beograd dhe Tiranë.

Ndeshja e fundit në Elbasan kishte shumë presion pas skenave të fundit në Serbi, ku kishin ndodhur ato skena që në fakt nuk janë aq të bukura për t'u rikujtuar. Tani jemi më të qetë, gjithçka është ndryshe. Kanë kaluar plot 11 vite nga ndeshja e Beogradit dhe besoj se të gjithë e kemi kuptuar se kur futemi në fushë jemi profesionistë dhe të gjithë futemi për të luajtur futboll. Për ne, janë të rëndësishme vetëm tre pikët dhe asgjë tjetër.

- Si e vlerësoni këtë ndeshje? Ndjeni presion për ta fituar?

Të gjitha ndeshjet kanë presion për ne. Nuk ka rëndësi nëse luajmë kundër Serbisë, Anglisë apo Andorrës. Ne vlerësojmë çdo ndeshje. E dimë që Serbia është një nga kundërshtarët tanë direktë, por nuk vendoset asgjë në këtë takim. Objektivi ynë sigurisht janë tre pikët dhe ne do të futemi në fushë vetëm për të marrë rezultat pozitiv.



- Si e keni përgatitur këtë ndeshje? A mund të na tregoni diçka më tepër, pasi përgatitjet nuk bëhen vetëm gjatë këtyre ditëve në Tiranë, por ju jeni në kontakt të vazhdueshëm me stafin teknik të kombëtares.

Po, është e vërtetë. Ne jemi në kontakt të vazhdueshëm me trajnerin, me stafin. Flasin, madje stafi vjen na ndjek edhe nga afër në ndonjë ndeshje. Kemi ende edhe disa ditë për t'i dhënë dorën e fundit dhe besoj se do të jemi gati.

- Sa e rëndësishme është kjo sfidë për ju, sigurisht nga pikëpamja sportive?

Siç thashë, kjo ndeshje është po aq normale sa ndeshjet me kundërshtarët e tjerë. Ne jemi profesionistë dhe si të tillë duhet të sillemi në fushë. Sigurisht që ne duam tre pikët, por jam i bindur që edhe ekipi serb ka të njëjtin qëllim. Ne duhet ta fitojmë sepse një fitore do të na ndihmonte për ëndrrën tonë për t'u kualifikuar në Kampionatin Botëror 2026.

- Çfarë mesazhi keni për tifozët?

Di të them që ne kemi tifozët më të mirë në botë, të cilët na kanë mbështetur jo vetëm kur kemi luajtur këtu, por në të gjithë botën. Do t'i kërkoja të na mbështesin edhe në këtë sfidë të rëndësishme për ne dhe të na japin kurajo.

Tarifa më të ulëta për transfertet në llogari bankare

Dërgo para nga Shqipëria direkt në
llogari bankare në vendet e BE dhe UK.



NDESHJA SHQIPËRI – SERBI

INTERES REKORD PËR BILETAT

**MBI 200 MIJË APLIKIME PËR
NJË STADIUM ME 22 MIJË VENDE**

Ndeshja e sotme Shqipëri – Serbi, e vlefshme për kualifikueset e Kampionatit Botëror 2026 është një nga përballjet me interesin më të madh të tifozëve shqiptarë ndër vite.

Për shkak të kërkesës së jashtëzakonshme për ndjekjen e kësaj sfide në stadium, Federata Shqiptare e Futbollit vendosi të zbatojë një procedurë të re për shpërndarjen e biletave, me qëllim menaxhimin sa më të mirë të kërkesës së lartë dhe shmangjen e abuzimeve.

Duke qenë se pritej që kërkesat të tejkalonin disa herë kapacitetin e stadiumit (dhe në fakt, nga rreth 22 mijë vende që ka stadiumi, pati mbi 200 mijë aplikime), FSHF vendosi të mos hapte menjëherë shitjen e biletave. Në vend të saj, u krijua një formular aplikimi elektronik, që qëndroi aktiv për 15 ditë në faqen zyrtare të FSHF-së, ku tifozët mund të shprehnin interesin për të marrë pjesë në shortin për bileta.

Pas përfundimit të këtij afati, nga data 31 maj deri më 4 qershor, kompania që menaxhon procesin e biletave, "T-Ticket", organizoi një short elektronik, ku

përzgjedhja e fituesve u bë në mënyrë krejtësisht rastësore. Për të garantuar transparencë dhe drejtësi, kompania aplikoi disa filtra sigurie dhe verifikimi për të eliminuar:

- » Aplikime të dyfishta apo të dyshimta,
- » Llogari të krijuara për spekulim ose abuzim,
- » Dhe për të siguruar që çdo individ të kishte vetëm një mundësi të barabartë pjesëmarrjeje.

FSHF ndërmori këtë proces për të luftuar fenomenin e abuzimit me biletat dhe shitësve të paligjshëm, të cilët operojnë në mënyrë të paligjshme. Ky model është i ngjashëm me atë që zbatohet nga UEFA në ndeshje me kërkesë të lartë, si finalët e Champions League, Europa League, Conference League apo Kampionatet Europiane, ku përzgjedhja e tifozëve bëhet përmes një shorti të drejtë elektronik.



FEDERATA
SHQIPTARE E
FUTBOLLIT



“AIR ALBANIA
STADIUM”



FEDERATA SHQIPTARE E FUTBOLLIT

ZYRTARËT E NDESHJES SHQIPËRI - SERBI

ROLI	EMËR / MBIEMËR	KOMBËSIA
Arbitër	DAVIDE MASSA	Itali
Asistent arbitër	FILIPPO MELI	Itali
Asistent arbitër	STEFANO ALASSIO	Itali
Arbitër i katërt	FABIO MARESCA	Itali
VAR	ALEANDRO DI PAOLO	Itali
Asistente VAR	DANIELE DOVERI	Itali
Vëzhgues i ndeshjes	RUNE PEDERSEN	Norvegji



RESPECT



FEDERATA SHQIPTARE E FUTBOLLIT